



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2545, datë 13.03.2015

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a për Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522 dhe 2525, datë 6.11.2014”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|----------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Zj Anila | Denaj | Anëtar |
| 4. Zj. Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| 5. Zj. Klarina | Allushi | Anëtar |

dhe sekretare Znj.Iris Xhanaj në mbledhjen e datës 13.03.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a për Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522 dhe 2525, datë 6.11.2014

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59 i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
4. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.
5. VKD nr. 2522, datë 06.11.2014 për “Miratimin Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme-Dokumenti Përfundimtar”;

6. VKD Nr.2525, datë 6.11.2014 Për "Percaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communications Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albanian Mobile Communications dhe vendosjen e masave rregulluese"
7. VKD nr.____, datë____2015, për "Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526, datë 6.11.2014"

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Albanian Mobile Communications sh.a. me nr.5746/1-Prot, datë 08.12.2014 (Referenca e AKEP: nr.2638 Prot., datë 10.12.2014) me anë të së cilës AMC ka paraqitur ankim administrativ ndaj Vendimeve të AKEP Nr.2522 dhe Nr.2525, datë 6.11.2014;
2. Shkresa e AKEP me Nr. 2723 Prot, datë 18.12.2014, drejtuar të katër operatorëve celularë për informacion shtesë mbi ankimet e tyre administrative;
3. Shkresa e Albanian Mobile Communications sh.a. me nr.5746/3 Prot., datë 23.12.2014 (Referenca e AKEP: nr.2726/2 Prot., datë 29.12.2014);
4. Shkresa e Vodafone Albania sh.a. dhe Albanian Mobile Communications sh.a. me referencë të Vodafone Ref CEO/051/MF, datë 22.12.2014 (Referenca e AKEP: Nr.2743 Prot., datë 22.12.2014), drejtuar institucioneve të Kryeministrisë, Kuvendit dhe MIAP.
5. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (Relacioni);

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendimin nr. 2522, datë 06.11.2014, ka miratuar dokumentin "Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së lëvizshme-Dokumenti Përfundimtar", dhe bazuar në këtë dokument janë marrë Vendimet nr.2523-2526, datë 6.11.2014, për percaktimin me FNT të katër operatorëve celularë për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre dhe masat përkatëse rregulluese për statusin e FNT.
2. Të katër operatorët celularë kanë depozituar në AKEP ankime administrative, sipas shkresave të cituara më sipër, si dhe informacion shtesë bazuar në kërkesën e AKEP. Secili operator ka ankimuar Vendimin nr. 2522, datë 06.11.2014, si dhe një apo disa nga Vendimet nr.2523-2526, datë 6.11.2014. Vendimet nr.2523-2526, datë 6.11.2014 kanë si pjesë arsyetuese dokumentin e analizës së tregut celular të miratuar më VKD nr.2522, datë 6.11.2014.
3. Albanian Mobile Communications sh.a në ankimin e depozituar me shkresën nr.5746/1-Prot, datë 08.12.2014 (Referenca e AKEP: nr.2638 Prot., datë 10.12.2014) ka kërkuar revokimin e pjesshëm të Vendimeve nr. 2522 dhe 2525

datë 6.11.2014, që kanë lidhje me miratimin e dokumentit të analizës së tregut celular dhe vendimin për Fuqinë e Ndjeshme në Treg dhe masat rregulluese për Albanian Mobile Communications sh.a. AMC. Në përfundim të gjithë pretendimeve të parashtruara, AMC kërkon nga AKEP:

1. Shfuqizimin e akteve administrative: Vendimit të AKEP Nr.2522, datë 06.11.2014 "Për Miratimin e dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme - Dokumenti Përfundimtar"; Vendimit të AKEP Nr.2525; datë 06.11.2014 për "Përcaktimin e sipërmarrjesit Albanian Mobile Communication sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të Albanian Mobile Communications dhe vendosjen e masave rregulluese", dhe heqjen e asimetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet celulare midis operatorëve celularë;
 2. AKEP të fillojë përgatitjen e një modeli të ri kostoje në bashkëpunim me operatorët e tjerë mobile, për llogaritjen dhe përcaktimin e kostove të terminimit në rrjetet celulare.
 3. Shoqeria AMC kërkon shfuqizimin e detyrimit për ndarjen e llogarive, i cili ka të bëjë me kontrollin e vendosjes së tarifave të terminimit nëse janë abuzive. Ndërkohe këto tarifa sipas vendimit të AKEP rregullohen me anë të metodës benchmark pure LRIC dhe kanë arritur nivelin më të ulët të mundshëm.
 4. Pezullimin e Vendimit të AKEP nr.2525, datë 6.11.2014 Për "Përcaktimin e sipërmarrjesit Albanian Mobile Communications Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të levizshëm Albanian Mobile Communications dhe vendosjen e masave rregulluese", sipas të cilit, AMC ndalohej të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarrjesit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare, dhe në rastin më të keq të mos marrjes parasysh të kërkesave dhe argumentave të paraqitura që lidhen me thelbin e vendimmarrjes, AMC kërkon shtyrjen për hyrjen në fuqi të tyre në datën 1 Korrik 2015, duke e vlerësuar si periudhë të nevojshme që shoqeria AMC do të marrë masat për implementimin e tij në kohë.
4. AKEP ka trajtuar ankimin e AMC, duke marrë në konsideratë edhe ankimet e tre operatorëve të tjerë celularë si palë të interesuara në vendimet e ankimuara, duke reflektuar përkatësisht në Vendimet nr.2522-2526, datë 6.11.2014. Këto ndryshime janë bërë nëpërmjet Vendimit të KD të AKEP me nr ___, datë ___.2015, vendim i cili përmban të plotë pjesën arsyetuese të ndryshimeve dhe trajtimin e ankimit të AMC.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S:

1. Pranimin e pjesshëm të ankimit administrativ të Albanian Mobile Communication sh.a., kundër Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. Nr.2522 dhe Nr.2525, datë 6.11.2014, duke bërë ndryshime në vendimet e cituara sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP me nr.____, datë____2015, për *“Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526, datë 6.11.2014”*..
2. Të njoftohet sipërmarrësi Albanian Mobile Communications sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban **KARAPICI**
2. Anila **DENAJ**
3. Ketrin **TOPÇIU**
4. Klarina **ALLUSHI**